

VENDIM
Nr. 79, datë 2.5.2024

**MBI KËRKESËN E SHOQËRISË “FTL” SHA PËR ZGJIDHJEN E
MOSMARRËVESHJES ME SHOQËRINË “DRAGOBIA ENERGY” SHPK**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 20, germat “a” dhe “ë”; të nenit 24, pikat 1, 2, 3, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të neneve 15 dhe 23, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), nr. 96, datë 3.9.2016; të nenit 11, të “Rregullores për trajtimin e ankesave të paraqitura nga klientët dhe për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve midis të licencuarve, në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror”, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 114, datë 8.7.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 2.5.2024, pasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Grupi i Punës me nr. 371/26 prot., datë 30.4.2024, “Mbi kërkesën e shoqërisë ‘FTL’ sh.a. për zgjidhjen e mosmarrëveshjes me shoqërinë ‘Dragobia Energy’ sh.p.k.”,

konstatoi se:

- Shoqëria “FTL” sh.a., nëpërmjet shkresës nr. 371/24 prot., datë 16.4.2024, ka paraqitur kërkesën për zgjidhje të mosmarrëveshjes me shoqërinë “Dragobia Energy” sh.p.k. ku në mënyrë të përmbledhur, ndër të tjera, parashtroi se: “Në kushtet e përcjelljes së planifikimit të prodhimit vjetor jashtë afatit kontraktor, njoftimi i datës 11.12.2023 dhe planifikimi vjetor i përcjellë nga kjo shoqëri nuk është marrë në konsideratë... Në këtë njoftim është deklaruar se një pjesë e sasisë së energjisë elektrike të prodhuar për periudhën 1.2.2024–31.12.2024, do të shitej në ALPEX”.

- Shoqëria “Dragobia Energy” sh.p.k., nëpërmjet shkresës nr. 371/21 prot., datë 8.4.2024, ndër të tjera, ka parashtuar se: “Dragobia Energy” sh.p.k. nuk është në shkelje të kontratës dhe është në përmbushje të çdo detyrimi kontraktor apo të çdo akti ligjor dhe nënligjor të sektorit të energjisë elektrike.

- Në nenin 24, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, “Zgjidhja e mosmarrëveshjeve nga ERE”, përcaktohet ndër të tjera se: “ERE vepron si autoritet për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve të lindura midis të licencuarve, në përputhje me rregulloren përkatëse të shqyrtimit të mosmarrëveshjeve dhe trajtimit të ankesave. Çdo palë e interesuar, që ka ankesa ndaj operatorit të transmetimit apo shpërndarjes, si dhe ndaj të licencuarve të tjerë, lidhur me zbatimin e detyrimeve të tyre, në përputhje me përcaktimet e këtij ligji apo akteve nënligjore të sektorit të energjisë elektrike, mund t’i paraqesë për zgjidhje pranë ERE-s”.

- Në këto rrethana, sqarojmë se: Shoqëria “Dragobia Energy” sh.p.k. është licencuar nga ERE me vendimin nr. 17, datë 16.2.2016, për prodhimin e energjisë elektrike nga HEC “Ceremi” dhe “Dragobia”, sipas përcaktimit në licencën e dhënë nga ERE, si dhe shoqëria “FTL” sh.a. është licencuar nga ERE për aktivitetin e furnizimit me energji elektrike dhe mban licencën seria 423-F18/F23, dhënë me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 199, datë 3.9.2018, dhe rinovuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 121, datë 4.4.2023.

- Duke qenë se palët: i. “FTL” sh.a. dhe ii. shoqëria “Dragobia Energy” sh.p.k., janë shoqëri të licencuara në sektorin e energjisë elektrike dhe ngrenë një problematikë për zgjidhje mosmarrëveshje, duke mbajtur qëndrime të kundërta, në lidhje me njoftimin e kontratës së shitjes së energjisë elektrike, ERE, në mbështetje të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, si dhe të “Rregullores për trajtimin e ankesave të paraqitura nga klientët dhe për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve midis të licencuarve, në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror”, miratuar me vendimin e Bordit të

ERE-s nr. 114, datë 8.7.2016, vlerësohet se palët legjitimohen për të kërkuar zgjidhjen e mosmarrëveshjes nga ERE.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Pranimin për shqyrtim nga ERE të kërkesës së paraqitur nga shoqëria “FTL” sh.a., për zgjidhjen e mosmarrëveshjes me shoqërinë “Dragobia Energy” sh.p.k., duke filluar procedurën për zgjidhjen e mosmarrëveshjes në përputhje me “Rregulloren për trajtimin e ankesave të paraqitura nga klientët dhe për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve midis të licencuarve, në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 114, datë 8.7.2016.

2. Drejtoria Juridike dhe e Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve të njoftojë palët e interesit për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti